



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.10, datë 5.2.2007

**PËR  
ANËTARËSIMIN E BASHKISË SË TIRANËS NË RRJETIN E FEDERATËS  
EUROPIANE PËR SOLIDARITET LOKAL PËR KOORDINIMIN E  
“DITËS EUROPIANE TË FQINJËSISË SË MIRË”  
(EUROPEAN NETWORK ON EUROPEAN FEDERATION OF LOCAL SOLIDARITY  
/ EUROPEAN NEIGHBOURS’ DAY COORDINATION)**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 8, pika I / a, b, dhe neni 32, ndryshuar me ligjin Nr.9208, datë 18.3.2004, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të japë pëlqimin për anëtarësimin e Bashkisë së Tiranës në Rrjetin e Federatës Europiane për Solidaritet Lokal për Koordinimin e “Ditës Europiane të Fqinjësisë së Mirë” (European Network on European Federation of Local Solidarity / European Neighbours’ Day Coordination).
2. Të miratohet kuota prej 1.000 euro çdo vit që Bashkia e Tiranës do t’i paguajë Federatës Europiane, si anëtare e Rrjetit të Federatës Europiane për Solidaritet Lokal për Koordinimin e “Ditës Europiane të Fqinjësisë së Mirë” (European Network on European Federation of Local Solidarity / European Neighbours’ Day Coordination).
3. Shuma prej 1.000 euro në vit, të përballohet nga shpenzimet operative të Bashkisë së Tiranës për vitin 2007.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Njësia e Përgatitjes dhe Koordinimit të Projekteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtorinë e Financës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**